

Nr. Prot. 004/B/15

## VENDIM Nr. 585

Për

### Ndalimin e Ushtrimit të Veprimtarisë të ofrimit të shërbimeve postare pa-autorizim (pa-licencë)

Në mbështetje të neneve; nenit 6 paragrafit 1.10);, nenit 21 paragrafit 1); nenit 28 paragrafi 1), nën-paragrafi 1.1); dhe nenit 43 paragrafi 1) pika 1.1) të Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare;; në referim të nenit 3, paragrafit 1) të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 për licencimin e operatorëve postar; dhe në mbështetje të nenit 79, paragrafëve 1) dhe 2), të Ligjit Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike; në referim të nenit 20 të Rregullores së Brendshme (Ref. Nr. Prot. 161/06) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si; Autoriteti), në bazë të shqyrtimit të administruar mbi Ankesën dhe kërkesën e Operatorit Publik Postar (tutje;OPP) 'Posta e Kosovës Sh.A', lidhur me hapjen e një pike (zyrës) postare në Komunën e Dragashit nga operatori i pa-autorizuar (pa-licencuar) 'JP Posta e Serbisë', Bordi Drejtues si organi ligjor dhe vendimmarrës i Autoritetit i përbërë nga;

- 1) z. Ekrem Hoxha, Kryetar
- 2) z. Besnik Berisha, Anëtar
- 3) z. Lulzim Kurtaj, Anëtar
- 4) z. Naser Shala, Anëtar
- 5) z. Nijazi Ademaj, Anëtar

në mbledhjen e saj të rregullt, të LXV), të mbajtur më datë; 27 Janar, 2015, bazuar në shqyrtimin e njoftimit dhe ankesës së parashtruar nga OPP 'Posta e Kosovës Sh.A', dhe provave të administruara nga zyrtarët e autorizuar sipas 'Autorizimit Specifik' (Ref.Nr. Prot. 009/2/15 datë; 20/01/2012), për inspektimin e 'JP Posta e Serbisë', e cila ka filluar me ofrimin e shërbimeve postare në mënyrë të pa-autorizuara në territorin e Komunës së Dragashit, me fillim nga data; 12 Janar, 2015, dhe në referim të bazës ligjore të cituar si më lartë dhe arsyetimeve të shpalosura përmes këtij dokumenti me konkluzione ekzekutive, unanimisht vendosi të nxjerr;

## V E N D I M

- I. Urdhërohet, ndalimi i menjëhershëm i ushtrimit të aktiviteteve të pa-licencuara (pa-autorizuara) postare në ambientet e pikës/zyrës së kontrolluar nga inspektorët e autorizuar të Autoritetit dhe/apo çdo pikë-e tjetër në territorin e Komunës së Dragashit me rrethinë pa siguruar autorizimet dhe licencat adekuate nga Autoriteti.

II. Urdhërohet, personi fizik, z. Ahmet JAMINI, qytetar i Republikës së Kosovës me vendbanim në Dragash, dhe me kartelë identifikimi të lëshuar nga MPB Prishtinë, në kapacitetin e Zyrtarit Përgjegjës të pikës/zyrës së pa-autorizuar postare, që të ndërpresë dhe ndaloj ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të ofrimit të shërbimeve postare.

III. Urdhërohen, personat fizik të identifikuar gjatë procesit dhe procedurave të kontrollit dhe inspektimit dhe të regjistruar me Akt Inspektimit e administruar nga inspektorët e Autoritetit (*Ref. kopje e Akt Inspektimit Nr.2015/03, datë; 22 Janar, 2015*), respektivisht;

- z. Ekrem KOIÇIN - në kapacitetin e punëtorit të sportelit;
- znj. Nadija SHUTRAK, - në kapacitetin e punëtore së sportelit; dhe
- z. Behair HUSEINI, - në kapacitetin e punëtorit të sportelit;

dhe/apo cilido person tjetër fizik në cilësinë e bashkëpunëtorit, i pa-regjistruar gjatë procesit të kontrollit dhe inspektimit si qytetar të Republikës së Kosovës që të ndërpresin dhe ndalojnë me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të ofrimit të shërbimeve postare si dhe/apo bashkëpunojnë në çfarëdo forme në ushtrimin e aktiviteteve të pa-licencuara (pa-autorizuara).

IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në ueb faqen e Autoritetit, [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org)

### **ARSYETIM**

Autoriteti me qëllim të;

- i. Pengimit dhe ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë ilegale të subjekteve të pa-licencuar/pa-autorizuar për ofrimin e shërbimeve postare në Republikën e Kosovës;
- ii. Përcjelljes dhe mbikëqyrjes së zhvillimeve që kanë të bëjnë me sektorin postar dhe tregun e shërbimeve postare;
- iii. Marrjes së masave të nevojshme për të siguruar barazi dhe transparencë për konkurrim në tregun e shërbimeve postare;
- iv. Sigurimit dhe krijimit të kushteve normale të operimit për operatorët e licencuar nga Autoriteti për ofrimin e shërbimeve postare sipas Ligjit për Shërbimet Postare, dhe Udhëzimit Administrativ për Licencim të Operatorëve Postar;

Autoriteti mbështetur në faktet dhe rrethanat;

- a) Përcaktimet e parapara sipas kornizës ligjore dhe rregullatore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, një ndërmarrës apo subjekt/person juridik i interesuar për ofrimin e shërbimeve universale dhe shërbimeve tjera postare, është i obliguar paraprakisht të pajiset me licencë nga Rregullatori (Autoriteti);

- b) Provat e pa-kontestueshme të siguruara gjatë kontrollit dhe inspektimit të ushtruar nga inspektorët e autorizuar të Autoritetit dhe të dokumentuara sipas Akt Inspektimit;
- c) Rekomandimin profesional dhe zyrtar të përgatitur dhe prezantuar nga njësi profesionale dhe funksionale, ajo e Sektorit të Shërbimeve Postare, në zbatim të mandatit për mbikëqyrje të tregut të shërbimeve postare;
- d) Duke e konsideruar si masë proporcionale ‘*vis-a-vis*’ e angazhimeve ndërkombëtare të dala nga përcaktimet e Marrëveshjes së Brukselit dhe zotimeve të komunikuar si pjesë e planit të veprimit për sektorin e shërbimeve postare;
- e) Duke e njohur dhe konsideruar se hapja e pikave të reja në territorin e Republikës së Kosovës pa siguruar autorizimet përkatëse nga organi kompetent nacional, është dhe mbetet i pa-pranueshëm dhe i pa-precedent si praktikë etj.

Atëherë Bordi i Autoritetit, unanimisht vendosi dhe udhëzoi Sektorin e Shërbimeve Postare si njësi funksionale dhe përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Shërbimet Postare dhe legjislacionin sekondar të aplikueshëm, që aktivisht ti mbikëqyr dhe ndaloj operimet e pa-licencuara nga ana e Autoritetit.

Njëherazi, Bordi udhëzoi shërbimet dhe zyrtarët e autorizuar të Autoritetit, që në rast të evidentimit të mos-respektimit të urdhëresës së nxjerr përmes këtij Aktvendimi, nga ana e personave fizik të urdhëruar sipas këtij aktvendimi për ndalim dhe ndërprerje të ushtrimit të aktiviteteve të pa-autorizuara (pa-licencuara), përmes vazhdimit në çfarëdo forme të ushtrimit të aktiviteteve të pa-autorizuara, sipas detyrës zyrtare të njëjtit në ushtrim të kompetencave dhe detyrave zyrtare të parapara me Ligj dhe zbatim të këtij Vendimi për mënjanimin e të gjitha shkeljeve të vërtetuara sipas paragrafit 1) të Nenit 28 të Ligjit për Shërbimet Postare, të procedojnë me kualifikimin e veprimeve të personave fizik të cituar sipas pikave II) dhe III) të këtij aktvendimi, si veprime në kundërshtim të plotë me dispozitat e përcaktuara sipas pikës 1) të paragrafit 1) të nenit 43 Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbime Postare dhe pikës 1) të nenit 8 të UA nr. 05/2012 për licencim të operatorëve postar, dhe sipas kualifikimit dhe procedurave respektive të ndjekura të procedohet me shqiptimin e dënimit-eve si kundërvajtje administrative duke përcaktuar edhe nivelin e masës sanksionuese si të parapara me paragrafin 1) të nenit 44 të Ligjit për Shërbimet Postare.

Siç edhe komunikuar përmes titullit të Aktvendimit, masat dhe veprimet e rekomanduara dhe të autorizuar nga Autoriteti sipas pikave II) deri III) të këtij Aktvendimi, i komunikohen për vëmendje qytetarëve subjekt i dispozitivit të Aktvendimit; dhe si kopje duke i kufizuar qasjen në provat e administruara do i dorëzohen për vëmendje të;

- Operatorit Publik Postar, ‘Posta e Kosovës Sh.A.’;
- Inspektoratit të Tregut, Komuna e Dragashit;

me qëllim të monitorimit të zbatimit të urdhëresës dhe aplikimit të parimeve dhe procedurave bazë për rregullimin e aktiviteteve të shërbimeve postare si të përcaktuara me/sipas Ligjit për Shërbimet Postare, në raste të mos-respektimit të urdhëresës dhe/apo vazhdimit të ushtrimit të aktiviteteve apo dukurive të ngjashme.

### **Këshilla Juridike**

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

**Prishtinë, 03/02/2015**

### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetar i Bordit**

### **Vendimi i dërgohet;**

- Qytetarit, z. Ahmet JAMINI (përmes postës "Rekomande");
- Tre qytetarëve tjerë të listuar në pikën III të Aktvendimit (përmes postës "Rekomande");
- Operatorit Publik Postar, Posta e Kosovës Sh.A;
- Inspektoratit të Komunës së Dragashit, përmes Kryetarit të Komunës;
- Ministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Ministres, Ministria Pa Portofol, Qeveria e Kosovës;
- Sektorit të Shërbimeve Postare dhe Departamentit Ligjor, ARKEP
- Arkivit të ARKEP